REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BUXHETIT
DREJTORIA E MENAXHIMIT DHE MONITORIMIT TË BUXHETIT

Nr. 8290/9 Prot. Tiranë, më 31/12/2013

# UDHËZIM

**Nr. 1/2 Datë 31.12.13**

## PËR NJË SHTESË NË UDHËZIMIN PLOTËSUES Nr. 1/1 datë 19.02.2013 " PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2013

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të Nenit 38 të Ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", nenit 19 të Ligjit Nr. 119 datë 17.12.2012 " Për Buxhetin e vitit 2013", dhe në vijim të Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr. 2 datë 6.02.2012 " Për procedurat standarte të Zbatimit të Buxhetit", paragrafi 2, Ministri i Financave:

**UDHËZON**

Në Udhëzimin Plotësues nr. 1/1 datë 19.02.2013 " Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2013", bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Në kreun I. " Proçedura specifike shtesë për zbatimin e Buxhetit te Shtetit", në pikën 25, shtohet germa "m", me këtë përmbajtje:

   " m. Të ardhurat e institucioneve, të realizuara nga fondet e akorduara nga Fondi i Posaçëm Për Parandalimin e Kriminalitetit dhe Edukimit ligjor".

2. Ky udhëzim hyn ne fuqi menjëherë.

**SHKËLQIM CANI**

**MINISTËR**